VENDIM
Nr. 658, datë 26.9.2012

PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË PËR VLERËSIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 13 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e metodologjisë për vlerësimin e pronave të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë, sipas aneksit 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Metodologjia për vlerësimin e pronave të paluajtshme është burimi i vetëm zyrtar për përllogaritjen e vlerës së pasurive të paluajtshme.

3. Miratimi i vlerës së pronës për secilin qark do të bëhet me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

4. Çdo akt tjetër nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohet.

5. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha